



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 623 prot.

Tiranë më, 27.04.2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 06, datë 27.04.2020

**PËR MASAT PROCEDURIALE DHE ADMINISTRATIVE
NË VEPRIMTARINË FUNKSIONALE DHE MBARËVAJTJEN E PUNËS NË
PROKURORITË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM NË FUNKSION TË
KUFIZIMIT TË PËRHAPJES SË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja "b" e "c" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 38 pika 2 shkronja "b", "c", "f", 46 pikat 1, 2, 3 shkronja "ç" të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", Aktit Normativ nr.9, datë 25.03.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19" i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.04.2020, vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.143 datë 22.04.2020 "Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore", si dhe në konsideratë të Udhëzimeve të Përgjithshme nr.2, datë 10.03.2020, nr.4, datë 24.03.2020 dhe nr.5, datë 07.04.2020, "Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19", dhe Udhëzuesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Rekomandime të përgjithshme ndaj subjekteve të biznesit që lejohen të zhvillojnë aktivitetin në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19" ;

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim për të siguruar, -mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, punonjësve të administratës dhe të shtetasve të interesuar për shërbime në prokurori, -mbarëvajtjen e punës në ambiente të shëndetshme, -vijimësinë normale të veprimtarisë ushtrimin e kompetencave në prokurori me rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, dhe -kufizimin dhe parandalimin e

transmetimit të infekzionit COVID-19 në ambjentet e punës, në prokuroritë me juridiksim të përgjithshëm

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij udhëzimi të përgjithshëm është përcaktimi i masave proceduriale dhe administrative për kufizimet dhe rregullat sipas praktikave të duhura të hiqenës për parandalimin e përhapjes së COVID-19, gjatë vijimit të veprimtarisë funksionale dhe administrative në prokuroritë me juridiksim të përgjithshëm.

KREU II

MASAT PROCEDURIALE PENALE

Neni 3

Veprimtaria funksionale në prokurori

1. Me rënien e kufizimeve të normuara në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, datë 07.04.2020 (vijues i atyre me nr.4, datë 24.03.2020, nr.2, datë 10.03.2020), “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksim të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infekzionit COVID-19” dhe me rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykata e të gjithë niveleve¹, më datë 27.04.2020 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksim të përgjithshëm vijon veprimeve në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave kushtetuese e ligjore të prokurorëve.

2. Në ushtrimin e funksioneve në fazën e hetimeve paraprake prokurorët në bashkërendim me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore të shërbime në strukturat hetimore përkatëse, (nëpërmjet komunikimit në distancë, me postë elektronike zyrtare, për aq sa është e mundur), përcaktojnë prioritet e çështjeve në ndjekje, sipas masave të sigurimit personal, “arrest në burg”, “arrest në shtëpi” dhe afateve përkatëse, etj, veprimet hetimore që duhen kryer në vijimësinë e hetimeve dhe mënyrën e kryerjes së tyre e afatet, duke planifikuar orare të ndryshme për thirrjen/pyetjen e dëshmitarëve dhe/ose ekspertëve, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera të nevojshme hetimore që duhen kryer për plotësimin e hetimeve, duke respektuar distancën dhe masat e tjera kufizuese të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Në ushtrimin e funksioneve në fazën e gjykimit prokurorët në bashkërendim me gjykatën kordinojnë datat/oraret për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjykatës sipas mënyrës së organizimit të shqyrimit gjyqësor të përcaktuar nga gjykata dhe duke respektuar distancën dhe masat e tjera kufizuese të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave prokurorët respektojnë kufizimet e përcaktuara në Aktin Normativ nr.9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.04.2020.

¹ Shih, vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.143 datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”.

5. Drejtuesit e prokurorive në gjithë nivelet pranë gjykatave me juridikcion të përgjithshëm marrin masat e duhura për vijimin e veprimtarisë në prokurori, në përputhje dhe respektimin e masave administrative për kufizimin e përhapjes së COVID-19.

KREU III

MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

Masat e përgjithshme të higjenës

1. Në ambientet e prokurorive me juridikcion të përgjithshëm duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjenës, ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim, letra dhe dezinfektante për pastrimin e sipërfaqeve dhe sigurimi i koshave të myllur për eliminimin e mbetjeve. Për dezinfektim mund të përdoren dezinfektuesit shtëpiak më të zakonshëm.

2. Prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit dhe punonjësve të administratës duhet t'i sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pajisja me mjetet mbrojtëse personale si maska dhe doreza (maskat mund të janë dhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë). Përdorimi i maskave dhe dorezave shërben si barrierë fizike për minimizimin dhe kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.

3. Në vendin e punës duhet të praktikohet pastrimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe elementeve të tjerë të vendit të punës si psh: ambjentet e përbashkëta dhe zyrat e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Produktet dezinfektante që përdoren për pastrim, të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë. Në çdo rast përdorimi i tyre bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale.

4. Në rast se sipërfaqet në vendin e punës janë të ndotura, duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë, para dezinfektimit.

Neni 5

Detyrimet e strukturës përgjegjese

1. Struktura përgjegjese duhet të vendosë postera që inkurajojnë higjenën e duarve për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme.

2. Struktura përgjegjese duhet të parashikojë një plan masash për të siguruar distancimin social dhe nëse kapaciteti i punonjësve kalon normën e lejuar për sipërfaqe në m^2 duke respektuar distancimin fizike 2 (dy) metër.

3. Në varësi të masave për distancimin social të parashikuar ne pikën 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse duhet të hartojë një politikë të brendshme për prokurorinë përkatëse për mënyrën e kryerjes së punës, konkretisht:

- Zbatimin e vendeve të punës fleksibël (p.sh. punë në distancë);
- Zbatimin e orëve fleksibël të punës (p.sh. ndërrime të orarit të punës/diteve të punës);

- c) Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve në vendin e punës;
- ç) Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve dhe qytetarëve (p.sh. përmes ndarjeve);
- d) Zbatimin e opsioneve fleksibël të takimit dhe udhëtimit (p.sh., shtyrja e takimeve ose ngjarjeve jo thelbësore);
- dh) Mundësimin e komunikimeve në distancë (p.sh. telefon, video ose ëeb).

4. Struktura përgjegjëse duhet të vendosë elementët e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemesë, si dhe rregullorja mbi masat e kufizimit për përhapjen e COVID-19 duhet të jete e publikuar në mënyrë sa më të dukshme dhe për publikun.

5. Në ambientet e secilës prokurori duhet të ketë një mjedis të caktuar për të izoluar një punonjës, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet 127-ta dhe Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësorë (NVKSH-ja) pranë qarkut dhe/ose bashkisë përkatëse.

6. Struktura përgjegjëse për aq sa është e mundur duhet të vendosë kamera për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjenës dhe kujdesit zbatohen me përpikëmëri.

7. Struktura përgjegjese për aq sa është e mundur duhet të përmirësojë kontrolllet inxhinierike me qëllim rritjen e niveleve të ventilimit dhe të përqindjes së ajrit që qarkullon në sistem si dhe pajisjen me tunelin dezinfektues në hyrje të institucionit.

Neni 6

Detyrimet e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës

1. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore i seksionitose dhe punonjësi i administratës:

a) nuk duhet të përdorë telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punonjësve të tjerë, kur është e mundur, si dhe nëse është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit;

b) duhet të përdorë mjetet e mbrojtjes personale si maska dhe doreza;

c) duhet të lajë duart ose të përdorë dezinfektantët në rast se janë të ndotura apo pas heqjes së maskës dhe dorezave;

c) nuk duhet të përdorë shtrëngimin e duarve por metoda të tjera jokontaktuese të përshëndetjes;

d) duhet të ruajë distancimin social/fizik gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij prej se paku 2 (dy) metër.

dh) duhet të respektojë praktikat e etikes respiratore, kollitjes e tështitjes nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës;

e) është i detyruar të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19. Në rast se ka patur apo ka kontakt të ngushtë me një person me Covid-19 duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturës përgjegjëse e cila më pas njofton NVKSH-në përkatëse.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 7

Përgjegjësia disiplinore

Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbën vepër penale², përbën shkelje disiplinore sipas ligjit.³

Neni 8

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të të gjithë llojeve dhe niveleve dhe nëpunësit civil e punonjësit e administratës të gjithë niveleve, në prokuroritë me juridiksim të përgjithshëm⁴.

2. Struktura përgjegjëse për zbatimin janë: -drejtuesi i Prokurorisë, kancelari ose kryesekretari në prokuroritë ku nuk ka kancelar, shërbimet administrative në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit me juridiksim të përgjithshëm, dhe - drejtuesi i strukturës përkatëse, Sekretari i Përgjithshëm, Sektori Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive, në vartësi të kushteve dhe rrëthanave të veçanta në prokurorinë që drejtojnë, mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm⁵.


Neni 9

Hyrja në fuqi, afati i zbatimit dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe detyrimet e përcaktuara në të zbatohen deri në njoftimin zyrtar përfundimin e masave të përhapjes së COVID-19

2 Udhëzimi i përgjithshëm të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme⁶.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM



² Shih, nenet 293/dh e 293/e të K.Penal, shtuar me ligjin date 16.04.2020.

³ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës, nenet 101 e 102 të ligjit nr 96/2016 "Për statustusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe nen 89 e vijues të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

⁴ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr. 97/2016.

⁵ Shih po aty nenet 46 pika 4.

⁶ Shih po aty nenin 43 shkronja "dh".